



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Gjuhë e Huaj C-1 Turqisht

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore, 40 seminare
Viti / Semestri: Viti 1, semestri 1
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti duhet të ketë njohuri themelore në gjuhën turke. Lënda gjuhë turke si gjuhë e dytë zhvillohet në dy module të vendosura në semestrin e parë dhe semestrin e dytë. Studentët do të punojnë me metodën e nivelit të avancuar, në nivelin A1- A 2 të metodës së përzgjedhur për mësim. Do dinë të përdorin aftësitë e të lexuarit kritik në gjuhën e huaj si leximi për të marrë kuptimin, për të nxjerrë konkluzione. Do përdorin strategji komunikimi.

Objektivat specifike lëndore :

- 1.Shkrimi i prezantimeve, organizim i mësimit në gjuhën turke.
- 2.Puna me fjalor të avancuar duke përdorur hamendësimin, nxjerrjen e kuptimit nga konteksti, njohjen e parashtesave dhe prapashtesave.
3. Zgjerimin e fjalorit duke përdorur përkufizimin, përdorimin e fjalëve në fjali.

Rezultatet e pritshme:

- 1.Përdorë gjuhën turke për të prezantuar veten dhe të tjerët, të kërkojë dhe japë informacion bazë personal në situata të zakonshme komunikimi.
- 2.Lexojë tekste të thjeshta në gjuhën turke dhe të kuptojë kuptimin e përgjithshëm dhe informacionin kryesor, duke aplikuar strategji leximi si hamendësimi dhe interpretimi nga konteksti.
- 3.Zbatojë metoda të përpunimit të fjalorit, si identifikimi i parashtesave/prapashtesave dhe analizimi i fjalëve të panjohura përmes kontekstit.
- 4.Shkruajë fjali dhe paragrafe të thjeshta, përfshirë prezantime të shkurtëra, përshkrime, dhe informacion personal apo tematik.
- 5.Zgjasë dhe përforcojë fjalorin aktiv, duke përdorur përkufizime dhe fjalët në kontekste të ndryshme në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme.